



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.09.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

**VENDIM  
PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENZIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT  
KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NDËRMARRJEN PUBLIKE  
LOKALE "PASTRIMI"**

I. **MIRATOHET**, Vendimi për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" të caktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve 15Nr.463/06-21274 të datës 26.04.2022.

II. Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve do të kompenzohen, për çdo muaj sipas pagës së përcaktuar minimale të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" ku të njëjtit shërbejnë.

III. Mjetet financiare për kompensimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve do të merren nga Ndërmarrja Publike Lokale "Pastrimi" ku edhe shërbejnë.

IV. Ky vendim vlen vetëm për anëtarët e komisionit të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës, përderisa kompensimin e anëtarit të deleguar nga Kryetari i Komunës këtij të fundit i rekomandohet ta rregulloj me vendim të veçantë.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Ndërmarrja Publike Lokale "Pastrimi"

VI. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-52742

Lipjan, më 28.09.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit  
Daut Azemi

